





KOMUNA RAHOVEC



[RAPORT 9 MUJOR I PUNËS]

JANAR – SHTATOR 2023

Zyra e Kryetarit Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n, 21000, Rahovec –Kosovës Tel: 0382004534

RAPORT 9 MUJOR I PUNËS

PËRMBAJTJA

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE	1
PËRFUNDIM.....	2

Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Rahovecit dhe njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në periudhën 9 mujore.

Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvízojë, progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të Komunës dhe ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2023, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitetesh përgjatë periudhes 9 mujore.

Në vazhdim DSHP ka raportuar për aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë ketij raportimi.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Është përfunduar vlerësimi i punëtoreve gjatë kësaj periudhe, për vitin paraprak,
- Ka pasur aktivitete me 3 kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore edhe pse nuk ka pasur të reshura të bores, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat,
- Është bërë ri-marrëveshja e re me me KRU Gjakovën, për investime publike si dhe trajtim të ujërave të zeza,
- Është aprovuar plani për vlersimin e rrezikut nga fatkeqësitetë natyrore dhe fatkeqësitetë te tjera,
- Është aprovuar plani për mobilitet,
- Është aprovuar plani i trasnportit rrugor lokal
- Janë sanuar dy segmente rrugore në fshatin Çifllak,
- Kanë filluar punimet në qytet nga kompania e kontraktuar, aktualisht punimet janë duke u zhvilluar ne rrugën "Ali Sokoli",
- Kanë filluar punimet në ndërtimin dhe rregullimin e përroskës në fshatin Celine,

RAPORT 9 MUJOR I PUNËS

- Është bërë propozim rregullorja e re për tarifa dhe për menaxhim të mbeturinave, ka kaluar në proces të diskutimit publik, është aprovuar edhe në kuvendin e komunes,
- Është përfunduar ndërtimi i rrugëve në fsh. Hoqë e Vogël, janë ndërtuar 5 semgjente rrugoresi dhe ndërtimi i rrugës në varrezat e dëshmoreve edhe martireve ne fshatin Hoçë Vogël,
- Është bërë ndërtimi i dy segmenteve rrugore në fshatin Polluzhë,
- Është përfunduar projekti edhe me 4 segmente rrugore në fshatin Pastasel,
- Ka pasur aktivitete ne rrugën 4 korsi, me kompaninë MENDI –P në Lot 3,
- Ne bashkepunim me zyrtarin nga GIS, është bërë harta e lirisë digitale si dhe është integruar ne platformën Rahoveci Dijital,
- Kemi filluar mbledhjen e te dhënavë për energji dhe klime, është bere grupi punues për monitorimin dhe mbledhjen e te dhënavë,
- Janë anuluar ne kete periudhe dy kontrata, sipas KVK, këto kontrata janë rishpallur sipas procedurës.

Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor

- Ka pasur aktivitete në ndërtimin e rrugëve ne qytet, rrugën “Ali Sokoli”, janë punuar instalimet nëntokësore, po ashtu sipas planit punimet janë përfunduar punimet ne ndërtimin e kanalit në rrugën “Shejh Mihedini” aktualisht rruga është e qarkullueshme,
- Gjate muajit prill ne kuvendin e komunës është aprovuar rregullorja dhe tarifa për taksen e mbeturinave,
- Gjate këtij muajit kompanitë e kontraktuara nga komuna kane pasur aktivitete në mirëmbajtjen e hapësirave publike, varrezave, lapidareve, si dhe hapësirave tjera ne rruge, ndërsa ne ditën e tokës kemi pasur aktivitete si institucione ne pastrimin e mbeturinave inerte dhe pastrim te rrugëve, hapësirave publike,
- Ka pasur zhvillime ne punimet me rrjet të ndriçimit publik janë duke u punuar në vendosjen e ormaneve, ka pasur disa intervenime në disa fshatra Dejn dhe Xërxe,
- Ka vazhduar projekti i ndërtimit të rrugëve në qytet, 6 segmente rrugore ne rrugën “Sadedin Hajda” janë përfunduar, po vazhdon projekti në disa lagje të qytetit,
- Kane filluar aktiviteti i punimeve ne ndriçim publik sipas kontratës me ESCO, ne fshatrat Vrajak, Bratatin, Senoc, Pastasel, Zatriq, Opterushe, Nagac, Celine, Zoqisht, Pataqan i Poshtem, Pataqan i Eperm,
- Po përfundon projekti i drizave dixhitale ne qytet sipas kontratës ESCO,
- Kanë përfunduar punimet me ndërtimin e trotuarëve në fshatrat, Potoqan i Poshtëm dhe Nashpall,
- Ka pasur aktivitete në punimet në ndërtimin dhe rregullimin e përroskës në fshatin Celine,

RAPORT 9 MUJOR I PUNËS

• Aktivitetet në periudhën: korrik, gusht, shtator

- Gjate kësaj periudhe fillojnë punimet me ndërtimin e rrjeteve te kanalizimit ne disa lagje te qytetit janë perfunduar,
- Ka pasur aktivitet me meremetimin e rrugëve me asfalt lot 1 si dhe me punimet me zgjerim te ndriçimit publik ne fshatin Zaqisht,
- Ka pasur aktivitet në mirëmbajtjen e hapësirave publike, varrezave, lapidareve, si dhe hapësirave tjera në rrugë, poashtu ka mirëmbajtje edhe te rrugëve ne zonën urbane,
- Është duke u implementuar projekt i zgjerimit të kanaleve për ujera te zeza sipas prioriteteve, kemi filluar punën ne pjesën e rrugës se UCK-së,
- Ka pasur një intervenim dhe një zgjidhje e problemit te kanalit te ujerave te zeza dhe rregullimit te rrugës ne fshatin Sapniq,
- Ne rrugën 4 korsi eshte duke vazhduar punimet lot 2,
- Kane perfunduar punimet ne ndërtimin e rrugëve lokale, dy rruge ne Pataqan te Eperm, dy rruge ne Nashpall dhe dy 4 rruge ne fshatin Pataqan i Poshtem me
- Janë duke vazhduar punimet ne Xerxe nga kompania Gashi-Ing.
- Ne rrugën katër korsi kemi zhvillime ne dy loto, ne lot 2 dhe 3 vazhdojnë punimet ndërsa ne Lot 1 me kompaninë Victoria Invest kemi ngecje te punimeve,
- Është duke u implementuar projekt i zgjerimit të kanaleve për ujera te zeza sipas prioriteteve, kemi përfunduar punimet ne Dabidol, tek objekti i zjarrfikësve, Mrasor dhe disa ndërhyrje tjera, Ratkoc, Rahovec dhe do te vazhdojmë me prioritete te tjera,
- Ka filluar trajtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, janë disa rruge ne qytet ku është bere trajtimi i tyre, rruga Gzim Hamza, Mulla Cufa dhe Xhelal Hajda ne disa pjesë, ka pasur ndërhyrje edhe ne disa rruge me rregullimin e ujëmbledhëseve,
- Është fituar projekt nga IPA 2019-2022 Programi ndërkufitar Kosove-Maqedoni e Veriut (Rahovec-Haraqine) i gropave septike Rahovec, Reti, Polluzhë, Potoqan i Epërm Potoqan i Poshtëm dhe Pastasel, vlera e projektit 694,973.32 euro ne total, ndërsa vlera e projektit për komunën tone është 282,958.06 si dhe për participim 42,443.72 euro,
- Ka filluar aksioni për eleminin e deponive ilegale, po ashtu ka filluar aktiviteti i mbledhjes se mbeturinave te vëllimshme,
- Është përfunduar një segment rrugor ne Fortese 150 metra,
- Është përfunduar puna ne asfaltimin e një rruge ne fshatin Celine me gjatësi 400 metra.

RAPORT 9 MUJOR I PUNËS

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për periudhen raportuese janë:

- Sfidat e drejtorisë do të jenë mundësítë buxhetore që kemi si drejtori, kemi shumë kërkesa të ndërtimit të rrugëve lokale të rrugëve dytësore dhe të pa kategorizuara;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës si dhe kërkesat e shumëta për zavendsimin e gypave të rinjë të azbestit.

Përfundim

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë periudhes raportuese.

Ju faleminderit!

Rahovec, 01.10.2023

Përparim Krasniqi

Drejtor i Shërbimeve Publike